

SHKUPI

LAJMËTARI INFORMATIV I QYTETIT TË SHKUPIT

NUMËR PA
PAGESE

SKOPJE

Numër 8 Viti II 12.10.2009



**FURNIZIM PERMANENT
DHE CILËSOR ME UJË PËR
30.000 BANORË**



„SHKUP“

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
„Shkupi“ u botua më:
10 dhjetor 2008

Del çdo të mërkurë të tretë të
muajit

Kryeredaktor
Nedelço Krstevski

Zëvendës kryeredaktor
Lupço Pandilovski

Redaksia
Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Redaktor i fotografisë
Radomir Jovanović

Perkthyes dhe lektorë
Merita Abdullai, Vladimir Bogdanovski,
Sadije Dalipi, Behar Dalipi

BOTON QYTETI I SHKUPIT
për botuesin
Kryetari i Qytetit
Koce Trajanovski
Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon
02 3297 255
02 3297 265

e-mail adresa
mediumi@skopje.gov.mk
gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni:
Evropa 92 - Koçanë



U LËSHUA NË PËRDORIM KANALIZIMI ATMOSFERIK NË AFËRSI TË ÇIMENTORES “USJE”

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski si dhe kryetari i komunës Kisella Voda, Marjan Gjorçev më 29 shtator e lëshuan në përdorim kanalizimin atmosferik në bulevardin “Serbia” afër çimentores “Usje”. Kanalizimi atmosferik në këtë drejtim arrin gjatësinë prej 560 metro, gjithashtu janë vendosur edhe tuba të armuara betoni, i qëndrueshëm ndaj ujit me profil prej 800 milimetra.

- Ky objekt i madh i infrastrukturës do ti mbledh ujërat atmosferike nga hapësira që graviton rreth çimentores “Usje” dhe në masë të konsiderueshme do ti zvogëloj

problemet me të cilat po ballafaqohen rreth 7.000 banorë gjatë të reshurave të furishme të shiut. Qyteti i Shkupit në ndërtimin e këtij kanalizimi atmosferik ka investuar rreth 8 milion denarë, mjete që tërësisht janë siguruar nga Buxheti i Qytetit. Në bashkëpunim me komunën e Kisella Vodës në kohë i kemi zgjidhur raportet pronëso-ro-juridike në këtë pjesë – theksoi Kryetari i Qytetit të Shkupit, Trajanovski, gjatë lëshimit në përdorim të kanalizimit atmosferik afër çimentores “Usje”.

Punët ndërtimore për ndërtimin e kanalizimit atmosferik i realizoi kompania “Energomont” nga Shkupi.

RRJETI I RI I UJËSJELLËSIT DO TË PËRMIROSOJ FURNIZIMIN ME UJË NË MAXHARI

Qyteti i Shkupit dhe NP „Ujësjiellësi dhe kanalizimi“ filluan me ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjiellësit në rrugën Pero Nakov në komunën e Gazi Babës. Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski dhe kryetari i komunës së Gazi Babës, Toni Trajkovski si dhe drejtori i NP „Ujësjiellësi dhe kanalizimi“, Igor Arnaudov, në fund të muajit të kaluar e vizituan vend ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjiellësit që do të përmirësoj furnizimin me ujë për 30.000 banorët e vendbanimeve Maxhari, Hipodrom, Çento si dhe zonën industriale lindore.

Fillojmë një projekt që ka rëndësi të madhe për Qytetin e Shkupit. Siç është e njohur, vendbanimet Maxhari, Hipodrom dhe Çento si dhe zona industriale lindore tani më po ballafaqohen me probleme të mëdha për sa i përket furnizimit me ujë. Por, tani po fillojmë me ndërtimin e rrjetit me gjatësi prej 650 metra me tuba të salduar hekuri të profilit F 500 milimetër. Rrjeti do të jetë cirkularë dhe do të mundësoj furnizim të vazhdueshëm me ujë për këto vendbanime në raste të defekteve të tubave ekzistuese F 700 milimetër që tani i furnizojnë me ujë vendbanimet Maxhari, Çento, Stajkovci, Trubarevë, Hipodrom dhe Inxhikovë. Investuesi i ndërtimit të rrjetit të ujësjiellësit është NP „Ujësjiellësi dhe kanalizimi“, kurse në teren do të punojnë ekipet e firmës „Vardar – Gradba“. Realizimi i këtij projekti kushton 20 milion denarë. Në periudhën e ardhshme mbetet obligimi që ta ndërtojmë ujësjiellësin prej „Agroservis“ deri te rezervuari i vendbanimit Çento si dhe rezervuarin e ri, dhe me këtë do të zgjidhet problemi me furnizimin me ujë të kësaj pjese të qytetit – theksoi Kryetari i Qytetit të Shkupit, në fillim të ndërtimit të rrjetit.

Sipas parashikimeve, ndërtimi i rrjetit të ujësjiellësit në Çento duhet të përfundoj deri në fund të tetorit, kurse në të do të rrjedhin 330 litra ujë në sekondë.

Deri më tani prej këtij rrjeti të ujësjiellësit janë ndërtuar 160 metro.



FILLOI NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË LISIÇË TË EPËRME

Ekipet e Qytetit të Shkupit në fillim të shtatorit filluan me ndërtimin e kanalizimit të ri fekal në bulevardin e ri të projektuar ASNOM në Lisiçë të epërme. Rrjeti do të jetë në gjatësi prej 1.200 metro, kurse për ndërtimin e saj do të ndahen 18 milion denarë nga buxheti i Qytetit të Shkupit.

Rrjeti i ri i kanalizimit fekal këto ditë po ndërtohet pa pengesa, edhe pse në kushte të vështirësuar, për shkak të terrenit të vështirë. Punëtorët ndërtimor thonë se ndërtimi po realizohet sipas dinamikës së paraparë..

- Po fillojmë me një projekt kapital i cili do ti zgjidh problemet lidhur me kanalizimin fekal dhe me të cilin po ballafaqohen rreth 35.000 banorë të vendbanimeve Lisiçe dhe Lisiçe e epërme. Me këtë, në masë të konsiderueshme do të përmirësohen kushtet e jetës në këto vendbanime dhe njëkohësisht do të mbrohet edhe ambienti jetësor. Tubat do të vendosen në thellësi prej gjashtë metro kurse do të jenë të profilit 500, 600 dhe 1.000 milimetër. Në ndërtimin e kanalizimit fekal do të punojnë ekipet e firmës "Energomont" – Shkup, dhe nëse premtojnë kushtet klimatike, ky objekt i infrastrukturës do të përfundohet brenda tre muajve – theksoi Kryetari i Qyteti të Shkupit, Koce Trajanovski gjatë vënies së gurë themelit të objektit të ri të infrastrukturës.

Kryetari i komunës Aerodrom, Ivica Konevski gjatë fillimit të punëve ndërtimore rreth kanalizimit të ri sqaroi se brenda njëzet ditëve pritet që të fillohet edhe ndërtimi i stacionit të pompës për rrjetin e ri fekal të cilin komuna do ta ndërtojë në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit.



VENDBANIMI KAMNIK ME UJËSJELLËS TË RI, SË SHPEJTI EDHE ME KANALIZIM FEKAL DHE ATMOSFERIK

Në projektin e përbashkët të Qytetit të Shkupit, komunës Gazi Baba dhe Ministrisë për Transport dhe Lidhje muajin e kaluar filloi të ndërtohet kanalizimi fekal dhe atmosferik në rrugën "Juzhnomoravski brigadi". Projekti është me vlerë prej 23 milion denarë.

Pas ndërtimit të kanalizimit fekal dhe atmosferik, punët ndërtimore në këtë drejtim do të vazhdojnë. Planifikohet rruga "Juzhnomoravski brigadi" të asfaltohet plotësisht, të zgjerohet dhe të ndërtohen trotuar.

Para fillimit me punët ndërtimore për kanalizimin fekal dhe atmosferik u lëshua në përdorim rrejtë sekondar i ujësjellësit në vend banimin Kamnik. Me këtë u zgjidh

problemi shumëvjeçar me furnizimin me ujë të pijshëm për më shumë se 2.500 banorë të lagjes Kamnik.

- Me ujësjellësin e ri banorët e Kamnik përfundimisht do të kenë ujë për të pirë sipas të gjitha standardeve. Të kënaqur me realizimin e këtij projekti, do të vazhdojmë me ndërtimin e rrjetit fekal dhe atmosferik me të cilën do të kompletohet infrastruktura në këtë pjesë të qytetit – tha kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski, në lëshimin në përdorim të rrjetit të ri ujësjellësit në Kamnik.



U PROMOVUAN UJËMATËSIT E RI ME MUNDËSI TË LEXIMIT PREJ SË LARGU



Si njëra prej masave për zvogëlimin e humbjeve të ujit në sistemin e furnizimit me ujë, ekipet e NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi" në periudhën e kaluar filluan me vendosjen e llojit të ri të ujëmatësve me lexim prej së largu në amvisëritë e qytetit të Shkupit. Llojin e ri të ujëmatësve në fillim të muajit e promovuan Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski dhe drejtori i NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi", Igor Arnaudov, në vendbanimin Lisiçe ku prej fillimit të vitit janë instaluar 700 ujëmatës me lexim prej së largu për amvisëritë.

- Ky projekt i Qytetit të Shkupit dhe i NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi" në masë të konsiderueshme e lehtëson procesin e leximit të ujëmatësve, në veçanti për ato ujëmatës që gjenden në vende ku

Përfitimet nga instalimi i ujëmatësve të ri:

- përgatitja e llogarive precize për ujin e shpenzuar si dhe shërbimi i përmirësuar
- zmadhimi shpejtësisë së leximit edhe atë për çdo muaj
- përmirësimi i saktësisë së leximit të ujëmatësve për shkak të eliminimit të pengesave të ngjara me leximin manual
- ujëmatësit sinjalizojnë defekte të sigurta në rrjetin e tyre të brendshëm
- respektimi i privatitetit të shfrytëzuesve të shërbimit për arsye se më nuk do të paraqitet nevoja për hyrje në pronat private

qasja deri te ato është e vështirësuar, gjithashtu ato shkurtojnë kohën e leximit dhe i paraqesin defektet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit nëpër amvisëritë me qëllim që të pengohet derdhja e panevojshme e ujit. Ujëmatësit janë të sigurt dhe i plotësojnë standardet evropiane – theksoi Kryetari i Qytetit të Shkupit, Trajanovski në promovimin e ujëmatësve të ri.

Në pajtim me tenderin për furnizimin e ujëmatësve me lexim prej së largu në vitin 2009 janë furnizuar gjithsej 4000 ujëmatës për amvisëritë, prej të cilëve 3 200 për instalim vertikal nëpër banesat e ndërtesave, 800 për instalim horizontal në shtëpitë individuale si dhe 95 ujëmatës të kombinuar industrial. Për furnizimin e ujëmatësve të ri do të shpenzohen 19 milion denarë. Prodhuesi i ujëmatësve është kompania austriake EWT (ELIN Wasserwerkstechnik Gesellschaft m.b.H.), e cila është njëra prej kompanive me repute botërore në

lëmin e prodhimit të ujëmatësve. Me qëllim që qytetarët të mos ngarkohen me shpenzime plotësuese, zëvendësimi i ujëmatësve klasik me ujëmatës me lexim prej së largu bie mbi NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi".

Sistemi për lexim prej së largu i ujësjellësve është i destinuar për pranim, analizë dhe bartje të impulseve të ujëmatësve me ndihmën e radio transmetuesit. Leximi i ujëmatësve me radiolidhje realizohet në dy mënyra: duke ecur në këmbë dhe nga automjeti në lëvizje. Instalimi i 4000 ujëmatësve për amvisëritë dhe i 95 ujëmatësve të kombinuar industrial me lexim prej së largu, është paraparë që të realizohet më vonë deri në mesin e vitit 2010.



FAZA E DYTË DHE E TRETË NGA PASTRIMI I SHTRATIT TË LUMIT VARDAR

Ekipe të Qytetit të Shkupit ditëve të fundit e pastrojnë shtratin e lumit Vardar, në anën e majtë, si pjesë e fazës së dytë dhe të tretë të aksionit të madh për pastrim. Në këto dy faza me makina do të pastrohen, do të tërhiqen dhe do të transportohen 5.000 metro kub mbeturina, kurse 30.000 kub mbeturina do të rrafshohen me ndihmën e makinave dhe do të mbulohen të gjitha gropat dhe vendet e parrafshuara në fund të shtratit.

Me këtë aksion do të pastrohen mbeturinat e hedhura, balta, lym, dhe degët. Në pastrim do të inkuadrohet edhe mekanizimi i NP "Rrugë dhe rrugica".

Në fazën e parë të pastrimit me dorë në shtratin e lumit Vardar u pastrua pjesa e pjerrët e shtratit minorë të lumit. Faza e dytë dhe e tretë e pastrimit të lumit Vardar realizohen sipas programit të Qytetit të Shkupit për mirëmbajtjen e shtratit minorë të lumit Vardar, kurse mjetet për këtë aksion u siguruan nga Buxheti i Qytetit të Shkupit.



ASFALTIMI I KORSISË PËR KËMBËSORË NË URËN "OBEDINETI NACII"

Ekipe të NP "Rrugë dhe rrugica" asfaltuan korsinë për këmbësorë në anën e urës "Obedineti nacji". Sipërfaqja e përgjithshme e asfaltuar 210 metra katror, kurse për asfaltimin e saj u përdorën 31 ton masë asfalti. Në korsinë, me gjatësi 100 metra dhe gjerësi 2,10 metra u vendos një shtresë asfalti me trashësi 6 centimetër.

Me këtë, përfundoi krejtësisht rikonstrukcioni i urës "Obedineti nacji" i parashikuar me programin e Qytetit të Shkupit, i cili përfshiu zëvendësimin e kapakëve me beton të armuar me kapakë të rinj, riparimin e shtyllave dhe vendosjen e shtyllave mbrojtëse me emblemën e Qytetit të Shkupit.

VEGLA SHKOLLORE PËR KATËR BINEQËT E PARË TË SHKUPIT



Katër bineqët nga lagjja Kozle të cilët këtë vit mësojnë në klasën e pestë në shkollën fillore „Vllado Tasevski” iu ofrua mundësia të zgjedhin çanta shkollore dhe ti mbushin ato me vegla shkollore (fletore, ngjyra, goma, lapsa etj.), si dhuratë nga Qyteti i Shkupit për fillim të suksesshëm të vitit të ri shkollorë.

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, Mirjanës, Slavkos, Simonës dhe Mihailit u dëshiroi vit të suksesshëm shkollorë dhe arritje të rezultateve të larta gjatë shkollimit.

PLOTËSIMI I ORARIT VOZITËS TË LINJËS ME NUMËR 60

Me qëllim të përmirësimit të qasjes në lokalitetin turistik Matka për të gjithë qytetarët e interesuar, Qyteti i Shkupit muajin e kaluar e plotësoi orarin vozitës ekzistues të linjës së autobusëve me numër 60 të NQP në pikë ndarjen Saraj-Matkë, gjë që vlen për ditët e diela dhe për festat shtetërore.

Nisja nga Saraji për në Matkë realizohet në këto termine kohore: 8; 12.30; 14.00; 15.10 dhe në ora 18.40.

Nisja nga Matka për në Saraj realizohet në këto termine kohore: 8.30; 13.30; 14.30; 15.30 dhe në ora 19.10.

SHKUPI DO TË MËSOJ PËR EFIKASITETIN ENERGJETIK NGA FRAJBURGU



Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, më 7 tetor në Frajburg, Gjermani e nënshkroi memorandum për mirëkuptim mes Shoqatës gjermane për bashkëpunim teknik (GTZ) dhe qytetet Frajburg, Shkup, Podgoricë, Sarajevë, dhe Zagreb për realizimin e projektit "Ndërtimi i kapaciteteve për menaxhimin me energjinë në qytete".

Ndër projektet e para të cilat Qyteti i Shkupit do ti realizojë, e për të cilat do të kërkojë ndihmë përmes këtij memorandum, është projekti për zvogëlimin e harxhimeve për ndriçimin rrugor. Ky projekt parashikon qendër dispeçere prej ku do të përcillet puna e ndriçimit publik, defektet dhe shpenzimin e energjisë.

Me kursimin e energjisë elektrike në Qytetin e Shkupit do të kontribuohet në zmadhimin e efikasitetit energjetik, ndërsa mjetet e kursyera do të shfrytëzohen për investime në shfrytëzimin e energjive të ripërtirra.

Efikasiteti energjetik në vitet e ardhme do të zbatohet edhe në institucionet publike të Qytetit të Shkupit. Projekti "Ndërtimi i kapaciteteve për menaxhimin me energjinë në qytete" hap mundësinë për të punësuarit në Qytetin e Shkupit që të trajnohen për përpilimin e projekteve për efikasitet energjetik.

Gjatë vizitës në Frajburg, kryetari Trajanovski realizoi takim me kryetarin e Qytetit Frajburg, Diter Solomon, ku dy bashkëbiseduesit këmbyen përvoja për punën e pushtetit vendor dhe administratës të qytetit.

Gjatë vizitës në Frajburg, kryetari Trajanovski realizoi takim me kryetarin e Qytetit Frajburg, Diter Solomon, ku dy bashkëbiseduesit këmbyen përvoja për punën e pushtetit vendor dhe administratës të qytetit.

Me rastin e Festës së Ramazan Bajramit

KRYETARI TRAJANOVSKI E VIZITOI BASHKËSINË FETARE ISLAME

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski me rastin e festës së Ramazan Bajramit e vizitoi Bashkësinë fetare islame, gjatë kësaj realizoi takim me Kryetarin e Bashkësisë fetare islame, Reis Ul Ulema, Haxhi Sulejman Efendi Rexhepi, sekretarin e përgjithshëm të BFI, Haxhi Afrim Efendi Tahiri si dhe me drejtorin e sektorit për arsim

fetar dhe shkencë pranë BFI-së, Haxhi Jakup Selimovski.

Kryetari i Qytetit të Shkupit Trajanovski, në emër të gjithë qytetarëve të qytetit të Shkupit, të gjithë besimtarëve të përkatësisë fetare islame iu uroi festën madhështore të Ramazan Bajramit. Gjatë kësaj ai atyre u dëshiroi mirëqenie, paqe dhe dashuri.



KRYETARI I QYTETIT TË SHKUPIT TRAJANOVSKI REALIZOI TAKIM ME DELEGACIONIN NG NURNBERGU

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, më 22 shtator, realizoi takim me antarët e delegacionit nga Qyteti Nyrnberg, Horst Ferter, zëvendës kryetar i qytetit Nyrnberg dhe Verner Trini, përgjegjës për bashkëpunimin e Nyrnbergut dhe Shkupit.

Në takimin me delegacionin nga qyteti i vëllazëruar i Nyrnbergut u diskutua për bashkëpunimin e frytshëm, të deritanishëm në mes dy qyteteve, që para së gjithash u shpreh në fushën e kulturës, artit, mbrojtjes sociale, mbrojtjes së mjedisit dhe në disa fusha tjera. Gjatë kësaj, që të dy delegacionet shprehën dëshirën që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe se i njëjti do të intensifikohet edhe në fusha të tjera, para se gjithash në fushën e tregtisë dhe të ekonomisë.

Gjatë vizitës zyrtare në Shkup, delegacioni nga Nyrnbergu e vizitoi edhe Shtëpinë e fëmijëve pa prindër „11 Tetori“ me çrast dhuroi donacionin prej 1.000 euro, i cili do të shfrytëzohet për blerjen e lavatriçeve për fëmijët e shtëpisë.

BËHET RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS NGA VODNO E MESME DERI TE **MANASTIRI “SHËN. PANTELEJMON”**



Ekipe të NP “Rrugë dhe rrugica” këto ditë po bëjnë rikonstrukcionin e rrugës nga Vodno e mesme deri te kompleksi i manastirit “Shën. Pantelejmon”. Duke pasur parasysh dëmtimet e mëdha të rrugës, përveç riparimit të gropave të thella do të përfundojë edhe rikonstrukcioni i plotë në pjesë të caktuara të rrugës me gjërryerjen me makineri deri në 10 centimetër dhe me nxjerrjen e sipërfaqes së asfaltuar.

Ky aktivitet ndërtimor do të kryhet në një sipërfaqe prej 400 metrash katror, kurse pastaj do të bëhet tamponimi me asfaltimi me makineri me masë asfalti prej 7 centimetrash..

FUNDJAVA LAKMITARE PËRSËRI E GJALLËROI SHKUPIN

Nga data 17 deri më 20 shtator sheshi para Kalasë ishte nikoqir i Festivalit të dytë ndërkombëtar të Kuzhinës popullore dhe Festivalit të birrës në Shkup “Fundjava lakmitare – MORE SOKOL PIE ... 2009”. Gjatë katër netëve të festivalit në Kalanë e Shkupit u prezantuan specialitetet gastronomike të ndryshme nga kuzhinat kombëtare evropiane dhe më shumë se tridhjetë lloje birrash nga birraritë më të mëdha evropiane dhe

botërore.

Manifestimin “Fundjava lakmitare – MORE SOKOL PIE ... 2009” e hapi kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, i cili theksoi se ky eveniment është pjesë e programit të Qytetit të Shkupit për gjallërimin dhe rivitalizimin e Çarshisë së vjetër të Shkupit.

- Ky festival është një eveniment ekonomik – kulturor që ka tendencë për tu bërë festivali më i madh maqedonas për

specialitete gastronomike dhe festivali më i madh i birrës, por edhe të mundësojë afrimin dhe ndërthurjen e kulturave të ndryshme në një vend – tha kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski.

Festivali i kuzhinës popullore dhe i birrës u shoqërua me shumë zbavitje dhe muzikë, shitje të prodhimeve artizanale, krijime artistike dhe shfaqje të artistëve nga Maqedonia dhe nga shumë vende evropiane.

SEMAFORË TË RI NË

Semaforë të ri që nga muaji i kaluar e rregullojnë trafikun në bulevardin “Vidoe Smilevski Bato”. Në periudhën e kaluar u realizua rekonstruimi i sistemit të semaforëve në këtë udhëkryq, gjatë kësaj u vendosën kontrollues të rinj si dhe instalimi i ri për lidhjen e semaforëve.

Mjetet financiare të projektit për semaforizim të udhëkryqit të ri në bulevardin “Vidoe Smilevski Bato” u siguruan nga buxheti i Qytetit të Shkupit, kurse punët i realizoi NP “Rrugët dhe rrugicat”.

BULEVARDIN “VIDOE SMILEVSKI BATO”



ËSHTË VENDOSUR GARDHI MBROJTËS NË VEND VROJTIMIN E EPËRM NË VODNO

Gardh i çeliktë i lartë dy metro, prej muajit të kaluar e mbron vend vrojtimin e rinovuar në pjesën e epërme të Vodnos, atë e mbron nga hedhurinat dhe dëmtimi i pajisjeve urbane. Gardhi mbrojtës është me gjatësi të përgjithshme prej 120 metro, e njëjta është e përforcuar me shtylla metali. Janë ngritur gjithsej 50 shtylla të metalta në lartësi prej 2.8 metro, të ngjyrosura me ngjyrë të gjelbërt.

Gardhin e vendosën ekipet e NP „Rrugët dhe rrugicat“, si pjesë e aktiviteteve të rregullta të Qytetit të Shkupit për mirëmbajtjen e park-pyllit Vodno.

MUZEU I QYTETIT TË SHKUPIT – NIKOQIR I QENDRËS PËR INDUSTRI KREATIVE

Në muzeun e Qytetit të Shkupit më 23 shtator u hap në mënyrë sol-emne Qendra për industri kreative. Bëhet fjalë për një projekt të suksesshëm drejt përkrahjes dhe fuqizimit të shkathtësive të punëtorëve kreativ dhe identifikimin e industrive kreative në Shkup.

Hapja e Qendrës është rezultat i memorandumit për bashkëpunim të nënshkruar ndërmjet Muzeut të Qytetit të Shkupit dhe Asociacionit maqedonas të zanatçinjve kreativ (AMZK).

VENDOSËN SHTYLLA NGA KOPSHTI ZOOLOGJIK DERI TE BARAKAT E QYTETIT

Ekipe të Qytetit të Shkupit vendosën 160 shtylla nga trari tek kopshti zoologjik deri në hyrjen e barakave të qytetit. Shtyllat janë vendosur me qëllim që të pamundësohet hyrja me automobil në këtë pjesë të Parkut të qytetit.

Në periudhën e ardhshme, shtyllat duhet të vendosen edhe nga shatërvani “Lotosov cvet” deri te hoteli “Kanet” dhe me këtë do të mbyllën të gjitha hyrjet në Parkun e qytetit për automobilat.

PLAKA BEKATONI NË PLATON PËRPARA GUASKËS

Ekipet e NP „Rrugët dhe rrugicat“ radhitën plaka të bekatonit në platon përpara Guaskës, në Parkun e qytetit. Plakat e bakatonit janë me ngjyrë të kuqe dhe ngjyrë hiri, ato janë vendosur në sipërfaqe prej 200 metro katrorë.

Guaska, si dhe platoja përpara saj shpesh shfrytëzohet për organizimin e manifestimeve kulturore, koncerteve të vogla dhe manifestimeve tjera. Me vendosjen e pllakave të bekatonit, kjo hapësirë e cila më parë ishte pa sipërfaqe të mirëmbajtur të barëzuar dhe e lënë në pluhur, do të marrë një pamje të rregulluar dhe urbane.



U ASFALTUAN RRUGËT E PORSA PROJEKTUARA NË RASADNIK



Ekipet e NP „Rrugët dhe rrugicat“ gjatë muajit të kaluar i asfaltuan rrugët në vendbanimin Rasadnik, komuna e Kisella Vodës. Është asfaltuar edhe rruga e porsa projektuar 2 në gjatësi të përgjithshme prej 162 metro. Rruga e porsa projektuar 3 është asfaltuar në pjesën e parë dhe të dytë në gjatësi prej 223 metro.

Sipërfaqja e tërësishme e asfaltuar në Rasadnik arrin rreth 1.000 metro katror, kurse shtesa e asfaltit arrin trashësi prej 10 centimetra.

Në vendbanimin Rasadnik, si pjesë e punëve të përfunduara për rregullimin e hapësirës janë vendosur edhe bekaton pllaka në trotualet dhe janë vendosur bordura përgjatë trotuareve. Për shkak të raporteve të pa definuara pronësoro-juridike mbetet që të vendosen edhe pllaka të bekatonit në trotualet në 500 metro katrorë të mbetur nga sipërfaqja e planifikuar.

KONKURS PËR RREGULLIMIN PARTER DHE HORTIKULTURORË TË NJË PJESE TË PARKUT TË QYTETIT

Qyteti i Shkupit shpalli konkurs për gjetjen e zgjidhjes ideore për rregullimin parter dhe hortikulturorë të lokalitetit në Parkun e Qytetit. Konkursi është publik dhe anonim, kurse të drejtë për pjesëmarrje në të kanë të gjithë personat juridik dhe fizik, shtetas të Republikës së Maqedonisë.

Punimet e arritura do të notojë komisioni i jurisë, i përbërë nga kryetari dhe dy anëtarë. Gjatë notimit të punimeve do të vlerësohen këto kriterë: realizimi dhe qëndrueshmëria, aspekti ekonomik i zgjidhjes së ofruar, inventiviteti në qasjen e formësimit, oferta e llojeve bimore dhe adaptimi i tyre në kushtet lokale klimatike, of-

erta e përmbytjeve programore dhe kompatibiliteti me destinimin e përgjithshëm të hapësirës, si dhe plotësimi i të gjitha dispozitave për lëvizjen e personave me nevoja të posaçme.

Projektet duhet të dorëzohen më së voni deri më 30.10.2009, në hapësirat e Qytetit të Shkupit, baraka numër 1.

Për fituesin e çmimit të parë në konkurs është siguruar çmimi prej 60.000 denarë, për vendin e dytë do të ndahen 30.000 denarë, kurse për fituesin e çmimit të tretë shpërblehet me 15.000 denarë.



U GJELBËRUAN ZHARDINERITË NË AERODROM

Ekipet e NP „Parqet dhe gjelbërimet“ këto ditë në mënyrë intensive po punojnë në rregullimin e zhardinerive të porsa ngritura në qytet. Zhardineritë në lagjen Aerodrom janë veçmas të

rregulluara, është vendosur rrjet i ri hidraulik si dhe sistemi për ujitje pikë për pikë, janë rregulluar pusetat, janë plotësuar zbrazëtirat në mes elementeve me fugë, gjithashtu është mbjellur edhe bar i ri.

Ndërtimi i zhardinerisë në Autokomandë, drejt urës në Singeliq, është në fazën përfundimtare. Është vendosur rrjeti hidraulik për ujitje

kurse ditëve të fundit përgatitet edhe shtresa tokësore. Kjo zhardineri është e gjatë 900 metro.

Në zhardinerinë në Bit Pazar mbillet barë, kurse po vendoset edhe sistemi i ujitjes pikë për pikë. Në zhardineritë e bulevardit “Partizanski odredi” duke filluar prej udhëkryqit afër “Simpò” deri te ura „Kombet e bashkuara“ me sipërfaqe të përgjithshme prej 3 kilometra vendoset rrjeti hid-

raulik për ujitje, është sjellur shtresë e re e dheut, janë rregulluar pusetat dhe po plotësohen fugat e elementeve.

Për zhardineritë e bulevardëve “8-të Shtatori” dhe “Revolucioni i tetorit” po përgatitet shtresa e dheut, pas kësaj do të pasojë instalimi i rrjetit hidraulik për ujitje dhe vendosja e sistemit pikë për pikë.

ZHARDINERI TË REJA DHE TRAM QASËS NË PARKUN E QYTETIT



Njëmijë e njëzet zhardineri të vogla nga muaji i kaluar e zbukurojnë Parkun e qytetit, në afërsi të Stadionit të qytetit. Zhardineritë me ngjyrë të bardhë dhe të kuqe, janë pozicionuar me plan në shtrirje prej shkallëve në afërsi të stadionit, përgjatë kosisë deri te kthesa. Ekipet e NP „Parqet dhe gjelbërimet“ i mbushën zhardineritë e vogla me dhe, dhe në to së shpejti do të mbillen fidane të vogla dhe lule sezonale.

Zhardineritë do të mundësojnë stabilizimin e pjerrësirave dhe pengimin e derdhjes së dheut gjatë të reshurave të shiut, gjithashtu kontribuojnë edhe për një pamje më të mirë estetike në këtë pjesë të parkut. Të njëjtat janë vendosur në dy ose në tri radhë, varësisht nga lartësia e pjerrësirave.

Ekipet e NP „Rrugët dhe rrugicat“ ndërtuan edhe tram qasëse afër shkallëve nga platoja përpara Stadionit të qytetit. Trami do ta lehtësojë qasjen e personave me nevoja të veçanta dhe të biçikletistëve në këtë pjesë të Parkut të qytetit.



U shënua Dita ndërkombëtare pa automobila

U PROMOVUAN PARKINGJET E REJA PËR BIÇIKLETA NË QYTETIN E SHKUPIT

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, më 22 shtator e udhëhoqi karvanin me biçikleta i cili u nis prej barakave të qytetit dhe qarkulloi deri te qendra tregtare "Bunjakovec", si pjesë e shënimit të Ditës ndërkombëtare pa automobila. Atij me biçikleta iu bashkëngjitën edhe zëvendës i Kryetarit të qytetit të Nyrnbergut, Horst Ferter, përfaqësues të më shumë ambasadave, ministri i ambientit jetësor, Nexhati Jakupi, kryetari i komunës së Karposhit, Stevço Jakimovski, anëtarët e administratës së qytetit. Para qendrës tregtare "Bunjakovec" u promovuan parkingjet e reja për biçikleta të cilat i vendosi Qyteti i Shkupit në suaza të projektit "ME BIÇIKLETË NË RREGULL! PO KU TË PARKOHEM?", i cili gjatë muajve të kaluar u realizua në bashkëpunim me shoqatën qytetare "Koalicioni për zhvillim të qëndrueshëm – KOR" dhe komunën e Karposhit..

- Kam kënaqësinë që në ditën e sotme i prezantojmë rezultatet e projektit "ME BIÇIKLETË NË RREGULL! PO KU TË PARKOHEM?". Biçikleta është një mjet më ekonomik transporti, ai nuk liron emisione të dëmshme në ajër, dhe përfitimet nga shfrytëzimi i biçikletave ne i kemi parasysh

në qëllimet tona që në vazhdimësi të punojmë në ndërtimin e korsive të biçikletave në qytet dhe në shënimin e tyre. Në suaza të këtij projekti ne i kemi caktuar edhe parkingjet e biçikletave në shtatë lokacione të qytetit, përgjatë korsive për biçikleta. Vazhdojmë punën në sistemin për dhënie me qira të biçikletave dhe po e fillojmë fushatën – "Vozitni biçikleta!" që ka për qëllim që të ngrit vetëdijen e qytetarëve që të shfrytëzojnë një mjet transporti më ekonomik, alternativ dhe ekologjik. Bëj thirrje deri te gjithë qytetarët që kanë mundësi që ta përkrahin dhe të marrin pjesë aktive në këtë fushatë

– porosi Kryetari i Qytetit të Shkupit Trajanovski në promovimin e rezultateve të projektit voluminoz në të cilin Qyteti i Shkupit punoi gjatë disa muajve të kaluar.

Projekti "ME BIÇIKLETË NË RREGULL! PO KU TË PARKOHEM?", kishte për qëllim që ta promovoj biçikletën si një mjet transporti të pranueshëm në mjediset urbane dhe përmes aksioneve konkrete si dhe përcaktimin e parkingjeve për biçikleta në më shumë lokacione të qytetit të kontribuoj për përmirësimin dhe zmadhimin e kapacitetit për parking të biçikletave në qytetin e Shkupit.





Tradita e qytetit vazhdon

NATA E BARDHË PËR HERË TË PESTË – NATA KULTURORE MË E GJATË NË SHKUP

Mijëra shkupjanë të shtunën, më 26 shtator, kishin mundësi të vizitonin një nga 25-së lokacionet nëpër Shkup dhe të gëzohen me shfaqjen, ekspozitat dhe performansat e artistëve nga 12 vende nga Evropa dhe bota në suazat e veprës së pestë dhe jubilarë të natës kulturore më të gjatë – “Nata e bardhë 2009”. Manifestimi tradicional filloi me hapjen e ekspozitës “Ndër hapësirë” me vepra të artit bashkëkohor nga nëntë artistë nga Banja Luka, në Muzeun e Qytetit të Shkupit. Vëmendjen më të madhe të vizitorët shkaktoi shfaqja spektakulare e grupit zviceran “Egzos” anëtarët e të cilit në sheshin “Maqedonia” shfaqën baletin në ajër “Suma”.

Të gjitha institucionet kulturore të Qytetit të Shkupit, si edhe vitet më parë u përfshinë në realizimin e programit të natës kulturore më të gjatë në Shkup. Adhuresit e artit mund të merrnin pjesë në evenimentet

e vetme kulturore të QKR, QIK, KO-RA, TPM, në Muzeun e Qytetit të Shkupit, Shtëpia e ARM, TPM, Stacioni vogël, në bibliotekën “Vëllezërit Miladinov” si dhe të Universitetit evropian, ku u hap ekspozita e studentëve të artit dhe dizajnit.

Uverturë në hapjen e “Nata e bardhë 2009” ishte koncerti muzikor i shkurtër i Orkestrës së mandolinave pranë QKR dhe koncerti solistik i këngëtarit maqedonas të operës Stojan Cvetanovski. Në Muzeun e Qytetit të Shkupit u mbajt edhe Four Strings Quartet nga Maqedonia dhe Robert Bisha nga Shqipëria, kurse u hap edhe ekspozita “Vizatim nga kënaqësia” nga artistë japonezë.

Para shtëpisë-monument të Nënë Terezës u mbajt lexim i poezisë, në stacionin e ri hekurudhor artistë të rinj vizatonin grafike, në shkallët e Qendrës tregtare të

qytetit u mbajt sfilatë mode, në disa kafene në rrugën Maqedonia ndaheshin libra, kurse në Guaskën në Parkun e qytetit publikun e zbavitnin disa dixhej në organizimin e “Vavilon porta”.

Shoqërimin kulturor gjatë gjithë mbrëmjes e pasuruan edhe shfaqjet e fëmijëve nga “Zllatno sllavejce” të cilët u prezantuan në Kopshtin zoologjik, shfaqja e studios së baletit – TUTU në Sallën universale, si dhe Shou i fëmijëve në Qendrën kulturore për fëmijë.

Në suazat e “Nata e bardhë” tradicionalisht edhe këtë vit në rrugën Maksim Gorki u mbajt gara e mirënjohur në stritbol ndërmjet ekepeve të përziera nga shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, manifestim që organizohet në bashkëpunim me Lidhjen e sporteve në Shkup dhe Federatën e basketbollit të Maqedonisë.



Me vendim të Këshillit të Qytetit të Shkupit

“DRISLA” U BË NDËRMARRJE PUBLIKE E VEÇANTË

Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e fundit dha pëlqim për formimin e Ndërmarrjes publike për deponimin e mbeturinave komunale “Drisla” – Shkup, me të cilën depoja “Drisla” ndahet nga NP “Higjiena komunale” si subjekt juridik i veçantë. Depoja “Drisla” funksiononte në suazat e NP “Higjiena komunale” në 6 vitet e kaluara.

Arsyet për formimin e ndërmarrjes publike të veçantë është nevoja e deponimit të veçantë dhe përpunimi i mbeturinave sipas të gjitha standardeve evropiane, me të cilën Shkupi do të ketë një depo sanitare bashkëkohore. Pavarësia e “Drisla” hap rrugën për projekte të mëtejshme për shfrytëzimin e energjisë ngrohëse dhe elektrike nga mbeturinat e përpunuara dhe gazi, si dhe mundësinë për riciklimin e mbeturinave. Deri tani, një

pjesë e vëmendjes dhe resurset e NP “Higjiena komunale” ishin përqendruar në mbledhjen e mbeturinave dhe nuk ishte kushtuar vëmendje e mjaftueshme deponimit të tyre dhe përpunimit, gjë që e solli depon “Drisla” në një gjendje të tillë alarmante.

Me formimin e Ndërmarrjes publike për deponimin e mbeturinave komunale “Drisla” – Shkup do të fitohet një tërësi kompakte e cila do të kontribuojë për organizim më të madh profesional dhe shfrytëzim më efikas të fuqisë punëtore, si dhe të potencialit profesional dhe mekanizimit që është në dispozicion.

Në periudhën e ardhshme, nëpërmjet kontratës trepalëshe ndërmjet ndërmarrjes së re të sapoformuar, NP “Higjiena komunale” dhe Qytetit të Shkupit, do të kontrahohen edhe bartje të tjera të kompetencave

ndërmjet të cilave edhe marrja e punëtorëve nga NP “Higjiena komunale” dhe sistemimi i tyre në NP “Drisla”, marrja e obligimeve në lidhje me procesin tekniko-teknologjik të punës së depos sanitare “Drisla”, si dhe punë nga fusha e zhvillimit dhe përparimit të procesit të mbledhjes, transportimit dhe deponimit të mbeturinave.

Në seancën e Këshillit u soll vendim për realizimin e procesit për zgjedhjen e konsultuesit për realizimin e procedurës për koncesion për ndërtimin e sistemit tramvaj, ndërtimin e dy rrugëve nëntokësore dhe ndërtimin e korsisë për ski në Vodno. Me këtë vendim, Qyteti i Shkupit do të fillojë procedurën për angazhimin e konsultuesit profesional për realizimin e procedurës për ndarjen e koncesionit subjektit të interesuar.



